



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 130/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sabrit Kurtishi nga Prizreni, kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e subjektit politik Koalicioni Vakrat, te paraqitur kundër Komisionerëve të QNR-së për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit në QNR, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Sabri Kurtishi, kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e VAKRAT.

A r s y e t i m

Me datën 31.01.2011 PZAP ka pranuar një ankesë nga Sabri Kurtishi, në të cilën pretendohet se në bazë të publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja lidhur me zgjedhjet të mbajtura me 12.12.2010 ka vërejtur që numri i votave nga KQZ-ja prej 177 votash në emrin e tij nuk përputhet me numrin nga 355 vota që ai ka fituar me numrin rendor 37, në bazë të rezultateve që i posedon.

Parashtruesi i ankesës ia ka bashkangjitur një kopje e cila sipas tij mund të verifikohet parregullsisht.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b)një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

- (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

PZAP-i konstaton se thëniet e theksuara në ankesë janë të pabaza për shkakun se pretendimet e parashtruesit nuk janë argumentuar dhe për më tepër lista ofruar si dëshmi nga parashtruesi i ankesës nuk ka asnjë fuqi ligjore që të arsyetoj pretendimet e theksuara dhe si e tillë PZAP nuk konsideron se është zyrtare. Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 130/2011 më datën 02.02.2011.

